



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 311 Prot.

Tiranë, më datë 07.07.2022

VENDIM

Nr. 367, datë 07.07.2022

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të aplikimit “Rindërtimi i objektit ekzistues 1 kat + podrum shtesë anësore dhe shtesë në lartësi”, Brenda kufirit Qendër Historike Korçë, me aplikues “Focus Architecture” sh.p.k. dhe zhvillues Xhuvit Sharxhi në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 07.07.2022:

VENDOSI:

1. Miratimin e projekt-propozimit “Rindërtimi i objektit ekzistues 1 kat + podrum shtesë anësore dhe shtesë në lartësi”, sipas VKM nr. 207, datë 15.3.2017 “Për Shpalljen e Qendrës Historike të qytetit të Korçës dhe Miratimin e Rregullores për Mbrojtjen, Konservimin e Integruar dhe Administrimin e saj e të Zonës së Mbrojtur Përreth”;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore të shqyrtimit dhe vendimmarrjes përkatëse, në organet e qeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 72, pika 1 dhe 2;
4. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ;
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Rudina ZOTO

